



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:259125

Datë: 02.07.2024

Numri i dokumentit: 05883029

**P.nr.2023:259125**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**/Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Afrim Gashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit V.K nga fshati Retijë, komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprën penale Përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafi 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.339/2023, të datës 19.01.2024 në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur, me datë 10.06.2024 në prezencën e Prokurorit të shtetit Qazim Kuqi, si dhe të akuzuarit së bashku me mbrojtësen-av.A.H nga Rahoveci, me datë 10.06.2024 mori dhe publikisht shpalli, këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**V.K**, nga i ati A, e ëma H, e lindur H, i lindur më datë .... në fshatin Retijë e Epërme, Komuna e Rahovecit, ku edhe banon, me numër personal ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër për ndonjë vepër penale.

### ËSHTË FAJTOR

#### Për shkak se:

**I.** Nga data e pa vërtetuar e deri me datë 28.02.2023 rreth orës 14:00 minuta, në fshatin Retijë e Epërme, Komuna e Rahovecit, i pandehuri mbanë në pronësi, kontroll ose posedim armë në kundërshtim me ligjin për armët Nr.05/L/022, në atë mënyrë që ditën kritike zyrtarët policorë kishin marrë informatë se i pandehuri posedon armë, ashtu që edhe intervistohet nga zyrtarët policor ku edhe vullnetarisht pranon se ka në posedim armën e tipit Z cal.9mm, së bashku me një karikator dhe katër fishek të cilët i mbante në pronësi në kundërshtim me ligjin mbi armët e të cilat po ashtu vullnetarisht i dorëzon të cilat edhe më pas sekuestrohen nga ana e zyrtareve policorë.

Me këto veprime ka kryer veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

**II.** Për shkak se me dat 31.12.2022 në fshatin Retijë e Epërme, Komuna e Rahovecit, i pandehuri përdor armën në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armë, në atë mënyrë që ditën kritike me rastin e ndërrimit të mot-moteve 2022-2023, me armën e gazit të tipit Z..., të kalibrit 9mm, ngjyrë e zezë, me nr.serik .... shkrep dy herë në ajër.

Me këto veprime ka kryer veprën penale Përdorim i Armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 6, 7, 17, 38, 39, 40 par. 1 nënpar.1.2 dhe 1.3, 42, 43, 44, 69, 71, 72 par.1.6, nenit 366 par.1, neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

Për veprën penale si në dispozitivin e I të aktgjykimit, **DËNIM ME GJOBË**, në shumën prej pesëqind (500)€.

Për veprën penale si në dispozitivin e II të aktgjykimin, **I shqiptohet DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve,

Pasi që gjykata ka shqiptuar dënimin si më lartë, me kërkesën e të akuzuarit, e në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve**, ia ka zëvendësuar në dënim me gjobë në shumën prej **njëmijë (1.000) €**.

Gjykata duke u bazuar në nenin 76 paragrafi 1 nën paragrafi 2.4 të KPRK-së, lidhur me bashkimin e dënimit, të akuzuarin e :

## **G J Y K O N**

Me dënim me gjobë në shumën e përgjithshme prej **njëmijepesqind (1.500) euro**.

Nëse gjoba nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në format tjera sipas nenit 43 të KPRK-së, e njëjta të akuzuarit do të i shndërrohet në dënim me burgim në kohëzgjatje prej shtatëdhjet e pesë (75) ditëve, duke llogaritur çdo ditë të burgimit me nga 20,00 (njëzetë) euro.

Në kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-së, së bashku me dënimin kryesor i shqipton:

## **DËNIM PLOTËSUES**

Të akuzuarit **V.K**, i konfiskohet pistoleta me gaz e tipit „Z...“ e kl. 9 mm, me ngjyrë të zezë, me nr. Serik..., një karikator, katër fishek me gaz, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Detyrohet i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor shumën prej tridhjetë (30) Euro si dhe në emër të kompensimit për viktimat e krimit shumën prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

### **1.Ecuria e procedurës penale**

Prokuroria Themelore Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.339/2023, të datës 19.01.2024, kundër të akuzuarit V.K nga fshati Retijë, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 dhe veprën penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 10.06.2024, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Qazim Kuqi, si dhe i akuzuari së bashku me mbrojtësen av. A.H nga Rahoveci.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit i cila ka qëndruar në tërësi pranë saj. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë e pranimit ose mospranimit të fajësisë, si dhe gjykata e ka njoftuar lidhur me efektet dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

### **2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë.**

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, e ndien veten fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe se ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur, është penduar për veprimin e bërë, dhe i premtoj gjykatës se një veprim i tillë nuk do të përsëritet.

Mbrojtësja e të akuzuarit – avokatja A.H ka deklaruar se e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të sajë, meqenëse është pranim që ka mbështetje në provat nga aktakuza si dhe është bërë në përputhje me kërkesat ligjore duke i propozuar gjykatës që të aprovohet ky pranim i fajësisë dhe duke kërkuar nga gjykata që me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese që janë prezente në rastin konkret ku dhe në fazën e hetimeve i pandehuri i ka pranuar veprimet inkriminuese pastaj pranimi i fajësisë edhe në seancën e sotëshme keqardhja dhe pendimi për rastin e ndodhur, çdo veprim i bërë nuk ka pas qëllimin që të shkaktojë pasoja për të cilat edhe akuzohet prandaj bazuar në të gjitha këto si dhe në dispozitat ligjore të nenit 70 dhe 44 të KPRK-së i propozoj gjykatës që ti shqiptohet një dënim sa ma i ultë dhe mundësisht dënim që parashihet me burg nëse eventualisht do ti shqiptohej dënim efektiv ti shqiptohet në atë lartësi që mundë të zëvendësohet me dënimin me gjobë.

Prokurori i shtetit jep mendimin lidhur me pranimin e fajësisë i cili ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë dhe pasi i ka kuptuar të drejtat, respektivisht favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu duke marrë për bazë se aktakuza ka mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike në dispozitiv të saj, ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale për të cilat ngarkohet i akuzuari. I propozoj gjykatës që i akuzuar të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë ligjor duke pasur

parasysh shkallen e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën ngarkohet. Gjithashtu me rastin e vlerësimit dhe caktimit të dënimit të ketë parasysh edhe qëllimin e dënimit duke i vlerësuar rrethanat lehtësuese, pranimin e fajësisë në këtë shqyrtim gjyqësor, pendimin e tij, premtimin se ne te ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër penale, ndërsa si rrethana rëndësues i lenë në vlerësim të gjykatës.

Gjykata konform dispozitave të nenit 364 të KPPK-së, e pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 241 të njëjtit Kod, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës të shqyrtimit fillestar është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk është lëshuar në procedurën e administrimit të provave.

### **3. Gjendja faktike e vërtetuar**

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se i akuzuari V.K me dashje ka kryer veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së., si dhe veprën penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

### **4. Elementet e veprës penale**

Në dispozitën e nenit 366/1 të KPRK-së, është parashikuar forma e veprimit me të cilin kryhet vepra penale: "Kushdo që mbanë në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mij e pesëqind (7.500)€ ose me burgim deri në pesë (5) vjet". Në dispozitën e nenit 367/1 është parashikuar forma e veprimit me të cilin kryhet vepra penale: "Kushdo që përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, dënohet me gjobë deri në dhjetë mijë (10.000)€ dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet".

### **5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues.**

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe Përdorim i Armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikurse ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat të cilat i përmbante aktakuza, e të cilat janë:

- Raporti i oficerit Avni Paqarizi, me nr. Të rastit 2023-EB-103, i datës 28.02.2023;
- Deklarata e të pandehurit V.K, dhënë në stacionin policor në Rahovec, me dat 28.02.2023 dhe prokurori me datë 17.01.2024;
- Lista e armëve të konfiskuara me nr. Të rastit 2023-EB-103, i datës 28.02.2023;
- Lista e dëshmive nga SP-Rahovec, e datës 28.02.2023;
- Foto albumi me nr.të rastit 2023-EB-103;
- Si dhe shkresat e tjera të lëndës.

-Gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit.

### **6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit,**

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69 ,70,71 dhe 72 par.1.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, e ka zbutur dënimin, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykim, është penduar për veprimin e bërë, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se i vjen keq për rastin e ndodhur, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë një veprim të tillë, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit ia ka shqiptuar dënimin me gjobë me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së.

## **7. Vendimipër shpenzimet e procedurës penale.**

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës që kërkesën pasurore – juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile bazohet në nenin 462 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor bazohet në nenin 452 par.1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L – 109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lartë, e në vështrim të nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr.2023:259125, me datë 11.06.2024**

**B. Profesional**  
**Afrim Gashi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Mizahir Shabani**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditëve, nga dita e pranimit nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë.